



# **K O D I I M I R Ë S J E L L E S**

## **RREGULLAT E MIRËSJELLJES SË SHËRBIMIT CIVIL**

1. Nëpunësit civilë i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të arsyeshme, të ndershme, të paanshme dhe në pajtim me ligjin.
2. Nëpunësit civil i kryejnë punët e publikut në mënyrë të shpejtë, me kurtuazi, me mirësjellje, me dashamirësi dhe pa paparagjykime apo neglizhencë.
3. Nëpunësit civil nuk duhet ta keqpërdorin funksionin e tyre zyrtar për përfitime personale apo për përfitime të tjerëve.
4. Nëpunësit civil i përdorin mjetet publike në mënyrë të ligjshme, në mënyrë efikase dhe vetëm sipas autorizimeve të Organit të punësimit për të cilin punojnë.
5. Përveç rasteve kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave zyrtare, nëpunësit civil nuk përdorin dhe nuk japin informata që janë fituar si rezultat i pozitës së tyre zyrtare.
6. Nëpunësit civil (nuk) duhet t'i paraqesin gabimisht apo t'i keqpërdorin informatat, apo të bëjnë orvatje për mashtrime.
7. Nëpunësit civil nuk pranojnë nga asnjë person apo subjekt tjetër të holla, dhurata, mikpritje apo ndihma lidhur me detyrat e tyre zyrtare dhe kontaktet e bëra, përveç nga organi i punësimit për të cilin punojnë, ose informatat e fituara në detyrën e tyre.
8. Nëpunësit civil nuk bënë ta pengojnë politikën e veprimit të zyrtarëve të zgjedhur.
9. Në zbatimin e urdhërave të tyre nëpunësit civil i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve.
10. Nëpunësit civil i zbatojnë udhëzimet e udhëheqësve të tyre, përveç nëse këto udhëzime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, të drejtat dhe liritë e njeriut ose të drejtat e komuniteteve.
11. Nëpunësit civil nuk marrin pjesë në kurrfarë aktiviteti politik dhe publik që mund të rrezikojë ose që duket se mund të rrezikoj paanësinë e tyre.